



**safejournalists.net**

# **Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor**

**Raport Narrativ 2022 – Kosovë**

# PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

8

PARANDALIMI I DUHUR

17

PROCESI I RREGULLT

26

SIGURIA FIZIKE

34

# Hyrje

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (Indeksi) është një instrument i bazuar në hulumtime, i krijuar për të matur dhe monitoruar ndryshimet në mjediset përkatëse sociale dhe politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sigurinë e gazetarëve dhe akterëve të medias gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Indeksi mbështetet kryesisht në provat hulumtuese të mbledhura dhe analizuara nga partnerët e [SafeJournalists.net](http://SafeJournalists.net) një platformë që zbaton një procedure rigoroze të hulumtimit. Të dhënat e mbledhura mbi dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të 'sigurisë së gazetarëve' janë përmbledhur dhe ndarë në një tregues të përzier – Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, për të matur ndryshimet në shtatë shtetet e Ballkanit Perëndimor me kalimin e kohës. Bazuar në provat hulumtuese, nëntë anëtarë të Panelit Këshillues në secilin shtet<sup>1</sup> vlerësojnë situatën dhe japin pikë (rezultate) për secilin nga 19 treguesit brenda dimensioneve të mëposhtme:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi i rregullt** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria fizike** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Indeksi u zhvillua bashkërisht nga studiuesit e Institutit RESIS<sup>2</sup> me bazë në Shkup dhe partnerët e platformës Safejournalists.net: Shoqata e Pavarur i Gazetarëve të

<sup>1</sup> Paneli këshillues në Kosovë përbëhet nga: Bojan Tomic, Dafina Halili, Imer Mushkolaj, Labinot Leposhtica, Lavdim Mekshana, Meneta Zekaj, Naile Dema Selmani, Nora Gjuzi, dhe Teuta Arifaj.

<sup>2</sup> Studiuesit e Institutit RESIS ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Tosheva kanë hartuar kornizën konceptuale për Indeksin dhe modelin e vlerësimit, peshimit dhe llogaritjes së tij.


Serbisë, Shoqata e Gazetarëve të BeH, Sindikata e Mediave të Malit të Zi, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve Kroatë dhe një studiues i pavarur nga Shqipëria<sup>3</sup>. Prandaj, Indeksi është rezultat i një pune të përbashkët të Platformës Safejournalists.net dhe mbulon të gjitha çështjet specifike që partnerët lokalë i identifikuan si të rëndësishme për kontekstin e vendit të tyre.

Viti i parë (pilot) për zhvillimin e kornizës konceptuale dhe metodologjisë për vlerësimin, mbledhjen dhe llogaritjen e indeksit ishte viti 2020. Ky raport i referohet situatës në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 dhe paraqet përmirësimin ose përkeqësimin e situatës për secilin nga katër dimensionet, duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2021 si vit reference. Më shumë detaje rreth kornizës teorike dhe procedurës së ndërtimit dhe llogaritjes së Indeksit, si dhe të gjitha raportet vendore të Ballkanit Perëndimor mund të gjenden në: (<https://safejournalists.net/safety-index/>).

---

3 Blerjana Bino është studiuesja e pavarur e platformës Safejournalists.net në Shqipëri.

## INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE



	2021	2022		Main new developments in each dimension
1. Mjedisi ligjor dhe organizativ	3,69	3,67	↓	Korniza ligjore e mediave në Kosovë përputhet me demokracitë e avancuara, por zbatimi mbetet sfidë. Procedurat për shpifje kundër gazetarëve nuk hetohen siç duhet, duke penguar vlerësimin e ndikimit të tyre. Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve respektohet, por paditë SLAPP janë në rritje, të cilat përdoren për të heshtur gazetarët dhe aktivistët. Gazetarëve nuk u kërkohet një licensë, por nevojitet një sindikatë gjithëpërfshirëse për punonjësit e medias në sektorin privat.
2. Parandalimi i duhur	3,49	3,38	↓	Qasja në masat e menjëhershme mbrojtëse për gazetarët e kërcënuar mbetet e pandryshuar. Rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj grave gazetare janë dyfishuar në vitin 2022. Sulmet verbale nga zyrtarët publikë janë rritur, ndërsa pengimi i policisë ndaj punonjësve të medias është ulur.
3. Procesi i rregullt	3,30	3,30		Qasja e Kosovës ndaj rasteve që përfshijnë gazetarë u përmirësua në vitin 2022, por mungesa e profesionalizmit dhe ekspertizës pengon zbatimin e duhur të masave mbrojtëse ligjore. Hetimet për sulmet mbeten të ngadalta dhe sulmet në internet vazhdojnë. Gjykatave dhe institucioneve të drejtësisë u mungon transparenca dhe të dhënat specifike për rastet e gazetarëve.
4. Siguria fizike	3,01	2,66	↓	Krahasuar me vitin 2021, 4 raste të tjera sulmesh, kërcënimesh, ngacmimesh dhe sulmesh ndaj gazetarëve kanë ndodhur gjatë vitit 2022. Përveç kësaj, këto sulme kanë qenë më të ashpra pasi kryesisht kanë ardhur nga zyrtarë të lartë dhe persona me ndikim.
<b>Indeksi i sigurisë së gazetarëve</b>	<b>3,24</b>	<b>3,05</b>	<b>↓</b>	

## — PËRMBLEDHJE

### I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Korniza ligjore e mediave në Kosovë mbetet në përputhje me standardet e demokracive të avancuara, megjithatë edhe sot e kësaj dite zbatimi i këtij ligji mbetet sfidë. Një çështje që ndikon seriozisht në situatën e këtij treguesi është fakti se gjykatat nuk kanë të dhëna për numrin e rasteve për shpifje ndaj gazetarëve dhe asociacioni i gazetarëve nuk ka kapacitet për t'i mbledhur këto të dhëna dhe për ta vlerësuar ndikimin negativ të procedurave për shpifje ndaj gazetarëve. Megjithatë, në krahasim me vitet e kaluara, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë më i hapur në krijimin e praktikave të reja për identifikimin e rasteve të gazetarëve.

- Situata në Kosovë, sa i përket konfidencialitetit të burimeve të gazetarëve, të garantuara me legjislacion dhe të respektuara nga autoritetet, mbetet e njëjtë si në vitet e kaluara. Që nga viti 2018 nuk ka pasur asnjë rast të ditur ku gazetarëve u është kërkuar t'i zbulojnë burimet e tyre, kështu që nuk ka pasur sanksione. Mbrojtja e burimeve gazetareske rregullohet me ligj; prandaj atyre u sigurohet mbrojtje e mirë.
- Për shkak të mungesës së të dhënave, nuk ka statistika nga vitet e kaluara për SLAPP dhe/ose padi të tjera ndaj gazetarëve. Për më tepër, deri më sot nuk ka asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP. Megjithatë, gjatë vitit 2022 ka pasur tendencë për përdorimin më të shpeshtë të SLAPP-ve (si dhe publikimin e tyre) për t'i heshtur gazetarët, por edhe aktivistët. Krahasuar me vitet e kaluara, më shumë raste janë bërë të ditura për publikun, siç është rasti i këngëtarit Gjiko ndaj Front Online, dhe tërheqja e padisë strategjike ndaj Agron Demit nga ana e ish-organeve drejtuese të PSB-së, nga Drejtori i Përgjithshëm aktual i PSB-së. Situata është përkeqësuar për shkak të bërjes publike të këtyre lloj padive, të cilat njerëzit me ndikim i kanë parë si formë për t'i heshtur gazetarët.
- Ngjashëm, si në vitet e mëparshme, gazetarët nuk kanë nevojë për licencë për t'i kryer detyrat e tyre profesionale. Megjithatë, AGK duhet të luajë rolin e sindikatave, përkundër faktit se është vendimtare që të krijohet një sindikatë gjithëpërfshirëse për punonjësit e mediave të sektorit privat.

## II. PARANDALIMI I DUHUR

- Situata për sa i përket qasjes së gazetarëve dhe akterëve të medias ndaj masave mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen gjatë kryerjes së detyrës mbetet e njëjtë në krahasim me vitin 2021. Si Policia ashtu edhe Prokuroria kanë caktuar një koordinator për trajtimin e rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Gazetarët i raportojnë rastet njësoj si çdo qytetar tjetër, por AGK është adresa kryesore ku gazetarët i raportojnë rastet e tyre. Bazat e të dhënave të AGK-së dhe PK-së kanë mospërputhje sepse disa raste nuk janë raportuar në të dyja institucionet, respektivisht. PK është efektive në hetimin e rasteve të kanosjes dhe dhunës ndaj gazetarëve, pa asnjë rast të njohur të autoriteteve që nuk përgjigjen apo nuk i përpunojnë raportet e gazetarëve apo mediave.
- Dispozitat ligjore, si Kodi Penal i Republikës së Kosovës që mbrojnë çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj, zbatohen edhe në rastet që kanë të bëjnë me gazetarët, pasi nuk ka dispozita ligjore që mbrojnë gazetarët më shumë se qytetarët e tjerë.

- Në krahasim me vitin 2021 kur kishte tri raste të sulmeve, kërcënimeve dhe ngacmimeve ndaj grave gazetare të raportuara në AGK, gjatë vitit 2022 numri i rasteve është dyfishuar. Gjatë vitit 2022 përveç 6 rasteve ndaj grave gazetare, janë shënuar 15 raste të sulmeve, nga të cilat një grup përfshin gra gazetare. Kosova e miratoi Konventën e Stambollit në shtator të vitit 2020, duke e bërë atë pjesë të ligjit kushtetues. Dhuna me bazë gjinore njihet si formë e diskriminimit vetëm me Ligjin për Barazi Gjinore. Format e dhunës me bazë gjinore janë vepra penale në Kodin Penal të Kosovës. Megjithatë, Kosovës i mungon një përkufizim gjithëpërfshirës dhe holistik i dhunës me bazë gjinore. Nuk ofrohet mbështetje e veçantë ligjore për gazetaret gra në raportimin e rasteve të ngacmimit dhe diskriminimit. Ngacmimi dhe diskriminimi mund të paraqitet në institucionet përkatëse. Kosova ka krijuar mekanizma për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë Prokurorinë e Shtetit dhe Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.
- "Gjatë vitit 2022 është rritur numri i rasteve kur zyrtarët publikë kanë përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetarëve. AGK ka regjistruar 11 raste duke përfshirë zyrtarë publikë, ndërsa 5 raste të tjera janë drejtuar nga persona publikë. Institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut, por deklarohen vetëm në rastet e dënimit të sulmit fizik, por nuk i adresojnë këto deklarata për sulm fizik nga politikanët apo zyrtarët. Ka pak mbështetje publike për gazetarët, dhe trendi i sulmeve verbale ndaj tyre është në rritje. AGK u bën thirrje zyrtarëve që të përmbahen nga gjuha e tillë pasi rrezikon sigurinë e gazetarëve dhe kjo gjuhë zakonisht çon në më shumë kërcënime dhe linçim nga ndjekësit e tyre, veçanërisht në internet."
- Në krahasim me vitin 2021, numri i rasteve kur policia ka penguar punonjësit e medias është ulur në një. Në përgjithësi, Policia e respekton profesionin e gazetarëve dhe nuk i pengon ata në punën e tyre.

### III. PROCESI I RREGULLT

- Gjatë vitit 2022 ka pasur një qasje më pozitive të KGJK-së ndaj rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët dhe lirinë e mediave në Kosovë. Mirëpo, edhe pse Policia, Prokuroria dhe Gjykatat kanë caktuar koordinatorët që merren me rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve, praktika tregon se ata nuk e kanë profesionalizmin dhe as ekspertizën e duhur lidhur me masat mbrojtëse ligjore në fuqi të parapara me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Si në vitin 2021, situata me hetimet e disa rasteve duket të jetë e ngadaltë dhe joefektive, pasi disa nga sulmet (si rasti i Shkumbin Kajtazit kur vetura e tij është qëlluar

me plumba dhe rasti i sulmit fizik ndaj Visar Duriqit) janë ende nën hetim dhe nuk janë zbardhur ende. Megjithatë, reagimi i parë i Policisë dhe Prokurorisë në shumicën e rasteve është urgjent dhe merret me prioritet; megjithatë, proceset gjyqësore që pasojnë nuk trajtohen me përparësi as nga prokuroria dhe as nga gjykatat.

- Gazetarët në Kosovë gjatë vitit të kaluar kanë qenë subjekt i 9 sulmeve, frikësimeve, kërcënimeve dhe fyerjeve online, në krahasim me vitin e kaluar ku numri i sulmeve të tilla ishte 8. Për shkak të reagimit të ngadalshëm të institucioneve të drejtësisë dhe mungesës së efikasitetit në trajtimin e rasteve kundër gazetarëve në procedurat penale dhe civile, masat ligjore të aplikueshme ishin pothuajse joefektive.
- Gjykatat nuk japin të dhëna për rastet e gazetarëve; megjithatë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i hapur për të vendosur modalitete për mbledhjen e këtyre të dhënave që ndikojnë në indeksin e sigurisë së gazetarëve. Transparenca, në mënyrën se si zhvillohen procedurat gjyqësore lidhur me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave, nuk është në nivelin e kënaqshëm.
- Policia, prokuroria dhe gjykatat publikojnë raporte vjetore statistikore që janë të aksesueshme për publikun. Megjithatë, kjo e dhënë është mjaft e përgjithshme, nuk jep informacione, statistika apo të dhëna specifike vetëm për rastet e gazetarëve që janë viktimat të veprave penale.

#### **IV. SIGURIA FIZIKE**

- Krahasuar me vitin 2021 kur kanë ndodhur 13 raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike, gjatë vitit 2022 ky numër është rritur në 19. Situata është përkeqësuar sidomos për shkak se shumica e këtyre kërcënimeve ndaj gazetarëve vijnë nga njerëz me ndikim, si Zotëria e Parë, Ministri i Punëve të Brendshme, Shefi i Kabinetit të Kryeministrit dhe zyrtarë të tjerë të lartë në Kosovë.
- Në krahasim me vitin 2020 dhe 2021, gjatë vitit 2022 nuk ka pasur raste të kërcënimeve për jetë dhe ndaj sigurisë fizike të gazetarëve.
- Numri i rasteve të sulmeve fizike ndaj gazetarëve është rritur në katër krahasuar me vitin e kaluar. Për më tepër, siguria e gazetarëve u rrezikua edhe me shumë se më parë, sepse këto raste ishin intensifikuar dhe shumica e rasteve ndodhën në pjesën veriore të Kosovës, ku Policia e Kosovës, KFOR-i dhe policia e EULEX-it kishin qasje të kufizuar.
- Numri i rasteve të sulmeve ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve është dyfishuar në krahasim me vitet e mëparshme. Ka pasur 3 raste në secilin nga vitet e kaluara; megjithatë, në vitin 2022 ky numër ka shkuar në 6.



# Mjedisi ligjor dhe organizativ

3,67



# Dispozitat ligjore lidhur me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk prodhojnë efekte dekurajuese tek gazetarët dhe mediat

**Rezultati për vitin 2021: 3,50 / Rezultati për vitin 2022: 3,50**

**Korniza ligjore e mediave në Kosovë mbetet në përputhje me standardet e demokracive të avancuara, megjithatë edhe sot e kësaj dite zbatimi i këtij ligji mbetet sfidë. Një çështje që ende ndikon seriozisht situatën në aspektin e këtij treguesi është fakti se gjykatat nuk posedojnë të dhëna për numrin e procedimeve për shpifje ndaj gazetarëve dhe shoqata e gazetarëve nuk ka kapacitet për t'i mbledhur këto të dhëna dhe për të vlerësuar ndikimin negativ të procedimeve për shpifje ndaj gazetarëve. Megjithatë, në krahasim me vitet e kaluara Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë më i hapur në krijimin e praktikave të reja në identifikimin e rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët.**

Fyerjet janë dekriminalizuar me kornizën ligjore në Kosovë; prandaj gazetarët nuk mund të jenë subjekt i hetimeve penale. Për më tepër, Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes përcakton përgjegjësinë civile ndaj qytetarëve apo gazetarëve. Pra, gazetarët nuk mund t'i nënshtrohen hetimit penal për raportimet apo opinionet e tyre.

Ligji për aspektet civile kundër shpifjes dhe fyerjes është hartuar për t'u zbatuar dhe interpretuar në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si një garanci për promovimin e lirisë së shprehjes dhe mendimit. Megjithatë, mungesa e njohurive dhe ekspertizës nga ana e gjyqtarëve për zbatimin e praktikave të KEDNJ-së përbën pengesë për promovimin e të drejtave të gazetarëve dhe mediave në Kosovë.

Ligji për shpifje dhe fyerje nuk parasheh dënime; ligji parashikon detyrimin për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga veprimet shpifëse ose fyese të të akuzuarit. Dëmshpërblimi i caktuar nga gjykata do të jetë në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar dhe do të përcaktohet vetëm për qëllim të kompensimit të dëmit të shkaktuar në reputacionin e personit ose për kompensimin e ndonjë dëmi financiar.

Zyrtarët publikë mund të ngrenë padi për shpifje ose fyerje privatisht dhe ekskluzivisht në cilësinë e tyre personale. Ka pasur një sërë aktakuzash SLAPP të ngritura kur një kompani ndërkombëtare që vepron në Kosovë ngriti një padi kundër një aktivisti civil të Kosovës dhe raste të tjera kur politikanët ngritën aktakuza.

Sipas të dhënave të mbledhura nga AGK-ja nga intervistat e detajuara me drejtues mediash dhe gazetarë gjatë vitit 2022, nuk ka asnjë rast në të cilin paditësi ka qenë politikan me ndikim; megjithatë, paditë SLAPP ndaj gazetarëve dhe aktivistëve janë iniciuar nga akterë të fuqishëm të korporatave.

Një problem që prek rëndë këtë indeks është se gjykatat nuk kanë të dhëna për numrin e padive për shpifje ndaj gazetarëve dhe shoqatat e gazetarëve duhet t'i mbledhin këto të dhëna përmes kanaleve të ndryshme, si organizata partnere, mediat dhe/ose nga vetë gazetarët. Numri i saktë i padive kundër gazetarëve nuk dihet. Organi përgjegjës për mbledhjen e të dhënave statistikore nga gjykatat e Kosovës është Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Përfaqësuesit e KGJK-së në një takim lidhur me këtë çështje deklaruan se nuk janë në gjendje të japin të dhëna zyrtare për numrin e padive kundër gazetarëve. Baza e të dhënave e KGJK-së ende nuk ka lejuar filtrimin e lëndëve në bazë të profesionit të subjekteve, shqetësim ky që AGK-ja e ka ngritur rregullisht para autoriteteve gjyqësore. KGJK-ja ka premtuar ndër vite se do ta përmirësojë mbledhjen e të dhënave por ende nuk ka bërë asnjë progres në këtë aspekt. Duke pasur parasysh këtë, gazetarët nuk deklarojnë se ndihen të vetëcensuruar, si dhe nuk autocensurohen, për shkak të ligjeve në fuqi.

Sipas përgjigjeve të gazetarëve gjatë një diskutimi në grup, ligji për shpifjen nuk konsiderohet dekurajues. Gazetarët hulumtues pretendojnë se ndjehen të lirë të hetojnë dhe të jenë kritikë në raportet e tyre.

Praktika e gjykatave për t'i dënuar me gjobë apo me kusht ata që kryejnë vepra penale ndaj gazetarëve, ka një ndikim shumë të fortë negativ ndaj gazetarëve. Një qasje e tillë konsiderohet shumë inkurajuese nga autorët e mundshëm për të kryer përsëri vepra të tilla në të ardhmen.

# Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me legjislacion dhe respektohet nga autoritetet

**Rezultati për vitin 2021: 4,61 / Rezultati për vitin 2022: 4,61**

**Situata në Kosovë për sa i përket konfidencialitetit të burimeve të gazetarëve e garantuar me legjislacion dhe respektuar nga autoritetet, mbetet e njëjtë si në vitet e kaluara. Që nga viti 2018 nuk ka pasur asnjë rast të ditur ku gazetarëve u është kërkuar t'i zbulojnë burimet e tyre, kështu që nuk ka pasur sanksione. Mbrojtja e burimeve gazetareske rregullohet me ligj; prandaj atyre u sigurohet mbrojtje e mirë.**

Mbrojtja e burimeve të gazetarëve garantohet me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Për të parandaluar një kërcënim serioz ndaj integritetit fizik që mund të rezultojë në vdekjen e një ose më shumë personave, gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias u kërkohet të zbulojnë burimin e informacionit vetëm me kërkesë të gjykatës përkatëse.

Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, i zbatueshëm në Kosovë, ka vendosur standarde dhe siguri për gazetarët, duke kufizuar detyrimin e tyre për të zbuluar burime anonime për ato që janë autorizuar nga gjykata. Ky ligj ka kufizuar aftësinë e policisë së Kosovës, prokurorisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit për të kërkuar zbulimin e burimeve anonime të gazetarëve pa vendim gjyqi.

Gjatë vitit 2022 nuk është raportuar asnjë rast kur autoritetet shtetërore kanë urdhëruar gazetarët t'i dorëzojnë pajisjet e tyre të punës, si celularin apo aparatën fotografik. Raste të tilla nuk janë raportuar në AGK që nga rasti i gazetares Saranda Ramaj, më 28 dhjetor 2018, kur ajo u nxor nga salla e gjyqit në seancën për rastin e organizatës "Syri i Popullit", derisa po dëshmonte presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Telefoni i saj është marrë nga njësi policore e ngarkuar me mbrojtjen e afërt të presidentit Thaçi.

Gazetarët u përgjigjën njëzëri se ndjehen të lirë të punojnë në tema që mbulojnë korrupsionin dhe gjithashtu ndjehen të lirë të kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e tyre të informacionit. Kjo për faktin se këto garanci në përgjithësi respektohen nga autoritetet.

# Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ua mundësojnë gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias të punojnë lirshëm dhe sigurt

**Rezultati për vitin 2021: 3,14 / Rezultati për vitin 2022: 3,06**

**Për shkak të mungesës së të dhënave, nuk ka statistika nga vitet e kaluara për SLAPP dhe/ose padi të tjera ndaj gazetarëve. Për më tepër, deri më sot nuk ka asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP. Megjithatë, gjatë vitit 2022 ka pasur tendencë për përdorimin më të shpeshtë të SLAPP-ve (si dhe publikimin e tyre) për t'i heshtur gazetarët, por edhe aktivistët. Krahasuar me vitet e kaluara, më shumë raste janë bërë të ditura për publikun, siç është rasti i këngëtarit Gjiko ndaj Front Online, dhe tërheqja e padisë strategjike ndaj Agron Demit nga ana e ish-organeve drejtuese të PSB-së, nga Drejtori i Përgjithshëm aktual i PSB-së. Situata është përkeqësuar për shkak të bërjes publike të këtyre lloj padive, të cilat njerëzit me ndikim i kanë parë si formë për t'i heshtur gazetarët.**

Gjatë vitit 2022 kameramani i agjencisë së lajmeve Ekonomia Online, Albion Selitaj, është arrestuar nga policia. Numri i rasteve është ulur për dy në krahasim me vitin 2021. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë rast që gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar me arsyetimin se nuk kanë pasur akreditim gjatë vitit 2022.

Deputetja e partisë në pushtet, Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka kërkuar rregullimin qeveritar të mediave, veçanërisht të portaleve online. AGK dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës reagon ndaj kësaj deklaratë pasi mediat në Kosovë e rregullojnë veprimtarinë e tyre përmes ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, si dhe Kodit të Mirësjelljes së Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Nuk ekziston asnjë mekanizëm që i mbron gazetarët nga paditë SLAPP dhe as Agjencia për Ndhimë Juridike Falas si agjenci publike e ndihmës juridike, nuk i kategorizon gazetarët si përfitues të ndihmës juridike në rastet kur përballen me paditë SLAPP.

Fillimisht, rastet e padive SLAPP janë iniciuar nga kompanitë ndërkombëtare dhe vendore që punojnë në sektorin e hidroenergjisë, por nuk ka një bazë të dhënash të organizuar në nivel institucional as nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe as nga gjykatat lidhur me paditë SLAPP. Ekspertja e Ligjit për Media, Flutura Kusari është e vetmja që pranon dhe merret me paditë SLAPP në Kosovë. Këtë vit, këngëtari Asdren Gjokolli i njohur si Gjiko, përmes firmës së tij përfaqësuese “Kërveshi & Partners”, ka ngritur padi për shpifje kundër Lavdim Hamidit, duke kërkuar masa të përkohshme për heqjen e një statusi në Facebook, me akuzat e Prokurorisë, si dhe duke kërkuar dëmshpërblim prej 5100 euro. Ai gjithashtu ka kërkuar nga Enis Veliu që ta heqë statusin e tij në Facebook në lidhje me procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij. Ky rast është perceptuar si rast i SLAPP nga OSHC-të në Kosovë. Mirëpo, edhe pse disa gazetarë dhe medie kanë qenë të paditur, ata nuk i paraqesin rastet për shkak të stigmës dhe frikës nga hakmarrja. Më 17 prill 2020, analisti i politikës në Institutin GAP, Agron Demi u padit nga ish-menaxhmenti i PSB-së, RTK. Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj (tani Drejtor i Përgjithshëm) me zgjedhjen e tij, në janar 2022 tërhoqi padinë strategjike ndaj Agron Demit.

Nuk ka pasur raste kur gazetarët janë ndaluar të raportojnë për protestat; megjithatë, gjatë vitit 2022 për shkak të barrkadave në veri të Kosovës, gjatë raportimit të tyre nga ky rajon kanë ndodhur 6 raste të sulmeve.

# Gazetarët janë të lirë ta ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë asociacione/ shoqata, t'iu bashkohen atyre dhe të marrin pjesë në to

**Rezultati për vitin 2021: 4,01 / Rezultati për vitin 2022: 3,98**

**Ngjashëm, si në vitet e mëparshme, gazetarët nuk kanë nevojë për licencë për t'i kryer detyrat e tyre profesionale. Megjithatë, AGK duhet të luajë rolin e sindikatave, përkundër faktit se është vendimtare që të krijohet një sindikatë gjithëpërfshirëse për punonjësit e mediave të sektorit privat.**

Gazetarët në Kosovë nuk është e nevojshme të licencohen nga shteti për të ushtruar profesionin e tyre dhe nuk janë bërë përpjekje për licencimin e tyre gjatë periudhës raportuese.

Nuk ka raste kur gazetarëve iu është refuzuar e drejta për të raportuar nga ngjarje të caktuara për shkak të mungesës së akreditimit, gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, një gazetare është penguar gjatë kryerjes së detyrave të saj profesionale. Gjatë vitit 2022, gazetarja e TV Syri (media lokale në Gjakovë) Edmonda Avdiya nuk është lejuar të hyjë në Departamentin e Transfuzionit të Gjakut në Spitalin "Isa Grezda" në Gjakovë, nga shefi i këtij departamenti, Kreshnik Abrashi, me arsyetimin se e kishte publikuar në portale kur u arrestua.

Nuk ka raste që gazetarëve t'i refuzohet e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar me arsyetimin se nuk kanë pasur akreditim gjatë vitit 2022.

Gazetarët kanë të drejtën e asociimit dhe lirinë për të krijuar sindikata. Ato përfaqësohen nga dy shoqata; AGK dhe ASJK.

Nuk ka pasur presione ndaj gazetarëve për t'iu bashkuar shoqatave që përfaqësojnë interesat e tyre gjatë periudhës së raportimit.

As Asociacioni jonë dhe as komuniteti i gazetarëve nuk janë në dijeni për ndonjë entitet mediatik paralel apo mashtrues.

# Vendet e punës së gazetarëve janë të qëndrueshme dhe të mbrojtura

**Rezultati për vitin 2021: 3,20 / Rezultati për vitin 2022: 3,20**

**"Gjatë vitit 2022 numri i anëtarëve të AGK-së është rritur. Baza e të dhënave të AGK-së përbëhet nga 900 anëtarë, me mbi 550 gazetarë nga të cilët 65% janë gra. Kushtet e punës së gazetarëve mbeten sfiduese, por nuk ka presion apo diskriminim në bazë gjinore. Gazetarët kanë frikë nga ngritja e padive për asociim ose mosrespektim të të drejtave të punës dhe krijimit të sindikatave në mediat private. Kushtet e gazetarëve të pavarur mbeten shumë shqetësuese, pasi pozicioni i tyre është më delikat për shkak të mungesës së stabilitetit; respektivisht stabilitetin financiar.**

Sipas bazës së të dhënave të AGK-së, të paktën 700 gazetarë dhe operatorë kamerash kanë nënshkruar kontrata pune në nivel qendror dhe lokal. Në vitin 2016, rreth 85% e gazetarëve kishin kontrata afatshkurtëra nga 6 muaj deri në një vit, ndërsa pjesa tjetër kishte kontrata të përhershme/ të pacaktuara. Situata mbetet e ngjashme edhe pse ende nuk ka informacion specifik për vitin 2022. Që nga 15 nëntori 2016 gazetarët e transmetuesit publik kanë punuar pa sigurime shoqërore, edhe pse PSB-ja kishte kontratë më parë me një nga kompanitë e sigurimeve. Situata mbetet e ngjashme me punonjësit e medias në sektorin privat.

Sfidat e gazetarëve në Kosovë mbeten të njëjta si në vitet e kaluara. Gazetarët edhe sot e kësaj dite kryejnë detyrat e tyre kryesisht në kushte shumë të vështira, pasi vazhdojnë të përballen me vështirësi të tilla si pagesa në para të gatshme dhe/ose skema të kombinuara, si dhe orë të gjata pune pa kompensim dhe/ose ndjenjën e jostabilitetit për shkak të mungesës së kontratave të përhershme. Për më tepër, kërcënimet fizike janë shtuar sidomos në pjesën veriore të Kosovës si rrjedhojë e zhvillimeve në tremujorin e katërt të vitit 2022. Brenda katër javësh janë regjistruar pesë raste të kërcënimeve të drejtpërdrejta ndaj gazetarëve në veri të Mitrovicës. Transmetuesi publik ende vazhdon të sfidohet nga hapësirat e vogla të punës, pasi punojnë në ndërtesa të huazuara nga qeveria, të cilat as nuk i plotësojnë nevojat dhe as kapacitetet e tyre.



Në përgjithësi, kushtet e punës së grave gazetare në redaksi nuk ndryshojnë nga ato të kolegëve të tyre burra. Nuk ka të dhëna të konfirmuara zyrtarisht se sa gra dhe burra kanë nënshkruar kontrata pune, por sipas disa vlerësimeve, në redaksi ka më shumë gra gazetare. Për më tepër, sipas bazës së të dhënave të AGK-së, e cila përbëhet nga 900 gazetarë, redaktorë, kameramanë dhe fotoreporterë, ka mbi 550 gazetarë dhe redaktorë, mbi 300 prej të cilëve janë gra.

Sipas bazës së të dhënave të AGK-së janë mbi 30 anëtarë të cilët janë profesionistë të pavarur dhe punojnë në mënyrë të pavarur kryesisht për agjencitë ndërkombëtare të mediave, si dhe mediat e OJQ-ve (lokale). Pozicioni i tyre është më delikat për faktin se nuk kanë kontrata dhe as të ardhura të rregullta dhe këta faktorë tregojnë paqëndrueshmëri.


Deri më sot, në Kosovë nuk ka sindikata gjithëpërfshirëse. Megjithatë, aktualisht janë tri, të cilat ku që të gjitha janë pjesë e PSB-së. Në këtë rast, AGK-ja luan rolin e Sindikatës dhe mbron gazetarët dhe të drejtat e punonjësve të tjerë të medias në vendin e tyre të punës. Duke ditur këtë, në Kosovë nuk ka marrëveshje kolektive të nënshkruara për mbrojtjen e të drejtave të punës së gazetarëve dhe punonjësve tjerë të mediave as në sektorin publik e as në atë privat.

Në shumicën e rasteve gazetarëve nuk u ofrohet ndihmë juridike falas nga media ku ata janë të punësuar. Ka vetëm një numër të vogël mediash në Kosovë që ofrojnë shërbime të tilla. Prandaj, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka ofruar AGK-së një këshilltar ligjor i cili do të përfaqësojë AGK-në dhe anëtarët e saj në rastet kur ata janë objekt i procedurave penale apo civile për shkak të raportimit të tyre.



## Parandalimi i duhur

3,38



# Gazetarët dhe akterët e medias kanë qasje në masa mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen

**Rezultati për vitin 2021: 3,39 / Rezultati për vitin 2022: 3,52**

**Situata për sa i përket qasjes së gazetarëve dhe akterëve të medias ndaj masave mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen gjatë kryerjes së detyrës mbetet e njëjtë në krahasim me vitin 2021. Si Policia ashtu edhe Prokuroria kanë caktuar një koordinator për trajtimin e rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Gazetarët i raportojnë rastet njësoj si çdo qytetar tjetër, por AGK është adresa kryesore ku gazetarët i raportojnë rastet e tyre. Bazat e të dhënave të AGK-së dhe PK-së kanë mospërputhje sepse disa raste nuk janë raportuar në të dyja institucionet, respektivisht. PK është efektive në hetimin e rasteve të kanosjes dhe dhunës ndaj gazetarëve, pa asnjë rast të njohur të autoriteteve që nuk përgjigjen apo nuk i përpunojnë raportet e gazetarëve apo mediave.**

Si Policia ashtu edhe Prokuroria kanë caktuar një koordinator kompetent për t'u marrë me rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Në polici dhe në prokurori nuk ka persona kontaktues dhe numra të posaçëm që gazetarët t'i raportojnë rastet e tyre. Gazetarët i raportojnë rastet njësoj si çdo qytetar tjetër, ndërsa koordinorët brenda këtyre institucioneve caktohen që të merren me rastet pas raportimit të tyre qoftë në polici, në prokurori apo në gjykata.

AGK është adresa kryesore për gazetarët për t'i raportuar rastet e sulmeve, kërcënimeve, frikësimeve dhe ngacmimeve ndaj tyre, si organizatë që avokon në emër të tyre. Po ashtu, gazetarët raportojnë rastet e tyre tek Policia dhe Prokuroria të cilët ndërmarrin masat e nevojshme për hetimin e këtyre rasteve - Gjatë vitit 2022 në PK janë raportuar 18 raste.

Bazat e të dhënave të AGK-së dhe PK-së kanë mospërputhje deri më tani, sepse gazetarët priren të mos ua raportojnë të gjitha rastet të djave, AGK-së dhe PK-së. Ka raste për të cilat AGK nuk është e njoftuar, pasi gazetarët kanë zgjedhur të mbeten anonimë. Gjithashtu,

— TREGUESI 2.1

sipas bazës së të dhënave të PK-së janë 6 raste ende në hetim. Rastet e mbetura janë referuar në Prokurori.

PK është institucioni më efektiv në hetimin e rasteve të frikësimit dhe dhunës ndaj gazetarëve. Nuk dihen raste kur autoritetet përkatëse nuk janë përgjigjur fare ose nuk kanë përpunuar/pranuar raporte nga gazetarë apo organe të medias në lidhje me shkeljet e të drejtave.

# Gazetarët dhe akterët e tjerë të medias (jeta apo integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të mbrojtjes speciale/sigurisë

**Rezultati për vitin 2021: 3,59 /  
Rezultati për vitin 2022: 3,48**

**Dispozitat ligjore, siç është Kodi Penal i Republikës së Kosovës, që mbrojnë çdo person që mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj zbatohen edhe në rastet që kanë të bëjnë me gazetarët, pasi nuk ka dispozita ligjore që mbrojnë gazetarët më shumë se qytetarët e tjerë.**

Nuk ka politika specifike apo mekanizma të tjerë të zhvilluar nga institucionet shtetërore për të mbështetur veçanërisht sigurinë e gazetarëve. Megjithatë, ekzistojnë dispozita ligjore, si ato të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në fuqi më 14 prill 2019), që mbrojnë çdo person i cili për shkak të punës mund të jetë viktimë e veprës penale. Ekziston edhe Ligji nr.04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, i datës 31 korrik 2013.

Sistemi ligjor i Kosovës nuk ka mekanizëm për vlerësimin e rrezikut që i dallon gazetarët nga qytetarët e tjerë.

Në vitin 2019, AGK nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK) që anëtarët e AGK-së të përfitojnë ndihmë juridike falas. Në vitin 2020, OAK në mënyrë të njëanshme u tërhoq nga ky memorandum mirëkuptimi, duke i lënë të pambrojtur gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave, veçanërisht gjatë pandemisë.

# Gazetaret kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

**Rezultati për vitin 2021: 3,57 / Rezultati për vitin 2022: 3,34**

**Në krahasim me vitin 2021 kur kishte tri raste të sulmeve, kërcënimeve dhe ngacmimeve ndaj grave gazetare të raportuara në AGK, gjatë vitit 2022 numri i rasteve është dyfishuar. Gjatë vitit 2022 përveç 6 rasteve ndaj grave gazetare, janë shënuar 15 raste të sulmeve, nga të cilat një grup përfshin gra gazetare. Kosova e miratoi Konventën e Stambollit në shtator të vitit 2020, duke e bërë atë pjesë të ligjit kushtetues. Dhuna me bazë gjinore njihet si formë e diskriminimit vetëm me Ligjin për Barazi Gjinore. Format e dhunës me bazë gjinore janë vepra penale në Kodin Penal të Kosovës. Megjithatë, Kosovës i mungon një përkufizim gjithëpërfshirës dhe holistik i dhunës me bazë gjinore. Nuk ofrohet mbështetje e veçantë ligjore për gazetaret gra në raportimin e rasteve të ngacmimit dhe diskriminimit. Ngacmimi dhe diskriminimi mund të paraqitet në institucionet përkatëse. Kosova ka krijuar mekanizma për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë Prokurorinë e Shtetit dhe Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.**

Procedurat për miratimin e Konventës së Stambollit në kuadër të legjislacionit të Kosovës kanë filluar në prill të vitit 2019. Konventa është miratuar në shtator të vitit 2020. Konventa e Stambollit tashmë është pjesë e ligjit kushtetues në Kosovë dhe sipas këtij zotimi institucionet janë të obliguara të ndërmarrin veprime ligjore dhe institucionale për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Konventa e Stambollit. Në nivel lokal, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore. Dhuna me bazë gjinore njihet si formë e diskriminimit vetëm me Ligjin për Barazi Gjinore.

Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ofron një përkufizim të dhunës në familje në procedurat civile, duke

vendosur kështu bazën për dhënien e masave mbrojtëse përmes urdhrave mbrojtës. Grave gazetare që janë viktime të ngacmimeve, kërcënimeve dhe/ose sulmeve nuk u ofrohet ndihmë shtesë nga institucionet përkatëse në raport me kolegët e tyre burra. Format e dhunës me bazë gjinore janë të dënueshme me Kodin Penal të Kosovës, duke përfshirë përdhunimin, sulmin seksual dhe abuzimin. Pavarësisht kornizës ligjore që mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore, siç parashikohet në Konventën e Stambollit, gjithashtu ndikon në ndjekjen dhe dënimin efektiv të dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Megjithatë, Kosovës ende i mungon një përkufizim i dhunës me bazë gjinore brenda procedurave të saj penale dhe civile. Kosova ka miratuar edhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili vlen për të gjitha veprimet apo mosveprimet e të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, personave fizikë dhe juridikë, sektorit publik dhe privat, të cilat cenojnë, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizikë dhe juridikë, në të gjitha fushat e jetës. Gjatë vitit 2021 nuk ka të dhëna për rastet e raportuara të diskriminimit me bazë gjinore.

Institucionet kanë krijuar mekanizma për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të Prokurorisë së Shtetit funksionon Zyra për Mbrojtjen e Viktimave e cila gjithashtu përfaqëson rastet e dhunës me bazë gjinore, ndërsa në kuadër të Agjencisë për ndihmë juridike falas, ndihma juridike falas u ofrohet viktimave të dhunës me bazë gjinore kur viktimat nuk janë në gjendje të paguajnë për të. Nuk ekziston ndonjë mekanizëm i veçantë që do të trajtonte në mënyrë specifike dhunën me bazë gjinore kur gazetaret femra janë viktime.

Nuk ofrohet mbështetje e veçantë ligjore për gazetaret në raportimin e këtyre rasteve. Megjithatë, gazetarët me kushte të vështira ekonomike mund të kërkojnë përfaqësim ligjor nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, pasi financat janë një nga kriteret kryesore për këtë dispozitë.

Ngacmimi hyn në kategorinë e veprave penale dhe rregullohet me Kodin Penal të Kosovës, ndërsa diskriminimi rregullohet me ligj të veçantë, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në të dyja rastet e ngacmimit dhe diskriminimit, gazetaret mund t'i paraqesin rastet e tyre në institucionet përkatëse.

# Është krijuar praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

**Rezultati për vitin 2021: 3,08 / Rezultati për vitin 2022: 2,92**

**"Gjatë vitit 2022 është rritur numri i rasteve kur zyrtarët publikë kanë përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetarëve. AGK ka regjistruar 11 raste duke përfshirë zyrtarë publikë, ndërsa 5 raste të tjera janë drejtuar nga persona publikë. Institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut, por deklarohen vetëm në rastet e dënimit të sulmit fizik, por nuk i adresojnë këto deklarata për sulm fizik nga politikanët apo zyrtarët. Ka pak mbështetje publike për gazetarët, dhe trendi i sulmeve verbale ndaj tyre është në rritje. AGK u bën thirrje zyrtarëve që të përmbahen nga gjuha e tillë pasi rrezikon sigurinë e gazetarëve dhe kjo gjuhë zakonisht çon në më shumë kërcënime dhe linçim nga ndjekësit e tyre, veçanërisht në internet."**

Edhe pse institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes, shkelje të të drejtave të njeriut dhe ligjit penal, zyrtarët publikë përmbahen nga deklaratat, përveç rasteve kur ndodhin sulme fizike ndaj gazetarëve. Këto deklarata nuk janë pjesë e diskursit të tyre të përditshëm, por vetëm në rastet kur ndodhin këto sulme.

Deklaratat e tyre kërkojnë dënimin e autorëve, por nuk reagojnë ndaj rasteve të gjuhës denigruese nga politikanë apo zyrtarë publikë/shtetërorë. Për më tepër, institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si shkelje e lirisë së shprehjes, ligjit për të drejtat e njeriut dhe ligjit penal, por pak është bërë për të ofruar mbështetje publike për gazetarët.

Megjithatë, pak është bërë nga ana e qeverisë për t'iu kundërvënë narrativave kundër gazetarëve.

Tendenca e politikanëve dhe zyrtarëve publikë që sulmojnë verbalisht gazetarët po rritet çdo vit. Vetëm gjatë vitit 2022 janë shënuar 11 raste të zyrtarëve publikë që kanë



— TREGUESI 2.4

përdorur gjuhë denigruese ndaj gazetarëve, ndërsa në 5 raste të tjera janë bërë nga persona publikë.

AGK në vazhdimësi u bën thirrje atyre që të përmbahen nga deklaratat të tilla për shkak se po rrezikojnë sigurinë e gazetarëve, pasi ftojnë ndjekësit e tyre (dhe/ose votuesit) t'i sulmojnë gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave.

# Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve

**Rezultati për vitin 2021: 3,85 / Rezultati për vitin 2022: 3,67**

**Në krahasim me vitin 2021, numri i rasteve kur policia ka penguar punonjësit e medias është ulur në një. Në përgjithësi, Policia e respekton profesionin e gazetarëve dhe nuk i pengon në punën e tyre.**

As Policia dhe as Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë në dokumentet e tyre strategjike objektiva apo aktivitete lidhur me trajnimin e zyrtarëve të tyre për trajtimin e rasteve ndaj gazetarëve.

Gjatë gjithë viteve Akademia e Drejtësisë organizon trajnime për prokurorët dhe gjyqtarët në lidhje me lirinë e fjalës. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë periudhës raportuese ka mbajtur trajnime për avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me lirinë e fjalës, lirinë e mediave, si dhe të drejtat dhe mbrojtjen e denoncuesve. Kryesisht PK-ja ka organizuar trajnime për marrëdhënie me media me pjesëmarrjen e një numri të zyrtarëve policorë, përmes të cilave ka rritur kapacitetet e brendshme për punë kompetente me media. Disa prokurorë dhe koordinatorë, zëdhënës, administratorë prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë të tjerë, kanë ndjekur trajnimet për marrëdhënie me mediat, kryesisht të mbështetura nga KiE, disa prej të cilave janë realizuar në bashkëpunim me AGK-në, ndërsa Departamenti për Siguri Publike në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë ka organizuar, mbështetur dhe financuar disa trajnime për policët në të gjitha rajonet e Kosovës. Është vlerësuar se ka ende nevojë për trajnime të mëtejshme.


Policia e Kosovës ka zhvilluar një bazë të posaçme të dhënash për rastet e gazetarëve dhe është në kontakt të ngushtë me AGK-në, organin që mbikëqyr rastet. PK është një nga institucionet më bashkëpunuese me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës.

Gjatë vitit 2022 ka pasur një rast ku policia ka penguar kameramanin e agjencisë së lajmeve Ekonomia Online, Albion Selitaj, teksa kryente detyrat e tij profesionale. Numri i rasteve kur policia ka penguar punonjësit e medias gjatë vitit 2022 është ulur në dy, në krahasim me vitin 2021.



## Procesi i rregullt

3,30



26

# Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

**Rezultati për vitin 2021: 3,61 / Rezultati për vitin 2022: 3,68**

**Gjatë vitit 2022 ka pasur një qasje më pozitive të KGJK-së ndaj rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët dhe lirinë e mediave në Kosovë. Mirëpo, edhe pse Policia, Prokuroria dhe Gjykatat kanë caktuar koordinatorët që merren me rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe ngacmimeve ndaj gazetarëve, praktika tregon se ata nuk e kanë profesionalizmin dhe as ekspertizën e duhur lidhur me masat mbrojtëse ligjore në fuqi të parapara me legjislacionin në fuqi në Kosovë.**

Zyra e Prokurorit të Shtetit caktoi një prokuror si Koordinator për të koordinuar dhe monitoruar rastet kur gazetarët janë viktima të krimit. Koordinatori gjithashtu mban bazën e të dhënave për raste të tilla. Baza e të dhënave është manuale. Megjithatë, një mekanizëm i tillë nuk është i besueshëm për të pasur të dhëna të qëndrueshme dhe të qasshme në lidhje me kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve.

Rastet ndaj gazetarëve trajtohen nga policia dhe prokuroria në të njëjtën mënyrë si veprat e tjera penale. Zyra e Prokurorit të Shtetit caktoi një koordinator kombëtar për t'i monitoruar dhe mbikëqyrur sulmet dhe frikësimet kundër gazetarëve. Për më tepër, praktika tregon se policia dhe prokuroria nuk e kanë profesionalizmin e duhur dhe as ekspertizën e duhur lidhur me garancitë ligjore të aplikueshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në Kosovë. Gjithashtu, nuk ka udhëzime apo politika të miratuara as nga sistemi prokurorial apo policia për trajtimin e rasteve të tilla.

Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Policia dhe Prokuroria janë më bashkëpunëtorët në krahasim me institucionet e tjera. Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit 2022 ka shfaqur interesim për gjetjen e modaliteteve për të bashkëpunuar më shumë me AGK-në. Megjithatë edhe sot e kësaj dite, Gjykatat dhe vendimet e tyre, mbeten arsyeja pse gazetarët hezitojnë të vazhdojnë më tej me çështjet e tyre.

# Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe akterëve të tjerë të medias kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, të tërësishme dhe të shpejtë)

**Rezultati për vitin 2021: 3,02 / Rezultati për vitin 2022: 3,02**

**Si në vitin 2021, situata me hetimet e disa rasteve duket të jetë e ngadaltë dhe joefektive, pasi disa nga sulmet (si rasti i Shkumbin Kajtaçit kur vetura e tij është qëlluar me plumba dhe rasti i sulmit fizik ndaj Visar Duriqit) janë ende nën hetim dhe nuk janë zbardhur ende. Megjithatë, reagimi i parë i Policisë dhe Prokurorisë në shumicën e rasteve është urgjent dhe merret me prioritet; megjithatë, proceset gjyqësore që pasojnë nuk trajtohen me përparësi as nga prokuroria dhe as nga gjykatat.**

INë përgjithësi, perceptohet se hetimet ndaj autorëve të kriminit ndaj gazetarëve janë të pavarura. Megjithatë, raste të tilla pasohen nga mungesa e profesionalizmit dhe ekspertizës në hetime, ndjekje penale dhe gjykime të rasteve ndaj gazetarëve. Sipas disa vlerësimeve të organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë edhe rastet ndaj gazetarëve, hetimi nuk bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse, por kryesisht fokusohet në veprat penale të sulmit dhe kërcënimit ndaj gazetarëve. Megjithatë, asnjë rast deri më sot nuk është hetuar apo ndjekur penalisht menjëherë në lidhje me ndonjë motiv politik apo ndonjë lidhje tjetër me grupet e interesit kundër gazetarëve.

Hetimi, ndjekja dhe gjykimi i rasteve të gazetarëve viktime të veprave kriminale duhet të ndjekë qasjen duale të institucioneve shtetërore. Reagimi i parë i policisë dhe prokurorëve në shumicën e rasteve është urgjent dhe me prioritet që në ditët e para të sulmit, edhe për shkak të reagimit publik të Asociacionit të Gazetarëve, të Mediave, si dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile. Megjithatë, procedimet e mëvonshme nuk konsiderohen si prioritet nga prokuroria apo

gjykata. Afati ligjor për procedurën hetimore është i rreptë dhe brenda 24 muajve prokurori duhet të ngrejë aktakuzë ose ta mbyllë çështjen penale pa veprime të mëtejshme.

Afatet ligjore brenda gjykatave nuk respektohen. Kjo ndikon që rastet ndaj gazetarëve të zgjaten përtej parimit për trajtimin e rastit brenda një afati të arsyeshëm. Shumica e rasteve kundër gazetarëve cilësohen si vepra penale të sulmit apo sulmit. Profesionin e gazetarisë bazuar në masat mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni në fuqi trajtohet si profesion me interes publik.

# Gazetarët dhe akterët e tjerë të medias mbrohen me efikasitet nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet

**Rezultati për vitin 2021: 3,04 / Rezultati për vitin 2022: 2,98**

**Gazetarët në Kosovë gjatë vitit të kaluar kanë qenë subjekt i 9 sulmeve, frikësimeve, kërcënimeve dhe fyerjeve online, në krahasim me vitin e kaluar ku numri i sulmeve të tilla ishte 8. Për shkak të reagimit të ngadalshëm të institucioneve të drejtësisë dhe mungesës së efikasitetit në trajtimin e rasteve kundër gazetarëve në procedurat penale dhe civile, masat ligjore të aplikueshme ishin pothuajse joefektive.**

Kodi Penal i Kosovës dënon ngacmimin në internet. Megjithatë, Kodi Penal nuk parashikon veprën penale specifike të ngacmimit të gazetarëve dhe dispozitat e tij zbatohen edhe për gazetarët kur ata janë viktimë e një krimi të tillë.

Gjatë vitit 2022, gazetarët në Kosovë kanë qenë subjekt i 9 sulmeve online, frikësimeve, kërcënimeve, fyerjeve, ndërsa ndaj 2 mediave ka pasur sulme kibernetike (Nacionale dhe Buletini Ekonomik). Këto kërcënime vijnë nga persona publikë dhe persona të lidhur me partinë në pushtet, por edhe nga qytetarët.

Në shkurt, Prindon Sadriu, bashkëshorti i Presidentes së Kosovës dhe një zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në një postim në Facebook i cilësoi gazetarët dhe mediat në Kosovë si "ndërmarrje të përbashkët kriminale". Në mars, shefi i kabinetit të kryeministrit, Luan Dalipi, në një postim në Facebook, lidhi mediat e Kosovës me "bizneset kriminale" dhe u bëri thirrje qytetarëve që t'i bojkotojnë ato. Deklarata të tilla rrezikojnë të minojnë besimin e publikut në media dhe të krijojnë një mjedis armiqësor për gazetarët.

Për shkak të reagimit të vonuar të institucioneve të drejtësisë dhe mungesës së efikasitetit të trajtimit të rasteve ndaj gazetarëve në procedurat penale dhe civile, masat ligjore në fuqi ishin pothuajse joefektive.

# Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe akterëve të tjerë të medias kryhen në mënyrë transparente

**Rezultati për vitin 2021: 3,18 / Rezultati për vitin 2022: 3,18**

**Gjykatat nuk japin të dhëna për rastet e gazetarëve; megjithatë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i hapur për të vendosur modalitete për mbledhjen e këtyre të dhënave që ndikojnë në indeksin e sigurisë së gazetarëve. Transparenca, në mënyrën se si zhvillohen procedurat gjyqësore lidhur me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave, nuk është në nivelin e kënaqshëm.**

Legjislacioni në fuqi në Kosovë parasheh që viktima e krimit ka të drejtë të kërkojë ndihmë dhe mbështetje nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave e cila është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Kjo zyrë ofron ndihmë profesionale për viktimën e krimit dhe gjithashtu ka për detyrë të kërkojë nga prokuroria dhe gjykatat respektimin dhe promovimin e të drejtave të viktimave gjatë të gjitha fazave të procesit gjyqësor. Nuk ka asnjë informatë se ndonjë gazetar ka kërkuar mbështetje ose ka marrë ndihmë nga kjo zyrë.

Prokurorët e Shtetit në Kosovë rrallë i informojnë qytetarët apo gazetarët lidhur me ndonjë fazë të procedurës penale kur janë viktima të krimit, e as nuk ofrojnë qasje në dosjet e lëndës. Bazuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, janë prokurori dhe gjyqtari i çështjes ata që japin informacione lidhur me statusin e secilit rast. Zëdhënësi i çdo prokurorie dhe zyre gjyqësore jep informacion për gjendjen e çështjes bazuar në reagimet e marra nga prokurori ose gjyqtari.

Gazetarëve u jepet qasjenë seancat gjyqësore në mënyrë jodiskriminuese, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rasteve gjyqësore kur ka urdhëra të gjyqtarëve për masa mbrojtëse. Megjithatë, në vitet 2019-2020 ka pasur një tendencë për të rishikuar Kodin e Sjelljes, i cili do të kufizonte aftësinë e gazetarëve për të raportuar nga seancat gjyqësore, duke i detyruar ata të prisnin deri në vendimin përfundimtar. Pas shqetësimeve të ngritura nga Asociacioni i Gazetarëve



— TREGUESI 3.4

të Kosovës, dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kjo tentativë është pezulluar nga KPM-ja. Nuk ka pasur raste të raportimit të gazetarëve kur nuk u është dhënë qasje në rastet e hapura gjyqësore në vitin 2022.

Gjykatat nuk japin të dhëna për rastet e gazetarëve; megjithatë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i hapur për të vendosur modalitete për mbledhjen e këtyre të dhënave që ndikojnë në indeksin e sigurisë së gazetarëve. Transparenca, në mënyrën se si zhvillohen procedurat gjyqësore lidhur me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave, nuk është në nivel të kënaqshëm.

# Janë ndërtuar sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave nga autoritetet për ta ndaluar mosndëshkimin

**Rezultati për vitin 2021: 3,65 / Rezultati për vitin 2022: 3,65**

**Policia, prokuroria dhe gjykatat publikojnë raporte vjetore statistikore që janë të aksesueshme për publikun. Megjithatë, kjo e dhënë është mjaft e përgjithshme, nuk jep informacione, statistika apo të dhëna specifike vetëm për rastet e gazetarëve që janë viktima të veprave penale.**

Institucionet shtetërore si Policia, Prokuroria dhe Gjykata publikojnë raporte vjetore statistikore të cilat janë të hapura për publikun. Duke qenë se të dhënat e tilla janë mjaft të përgjithshme dhe nuk janë të ndara për fusha të veçanta, ato nuk japin informacion, statistika apo të dhëna konkretisht vetëm për rastet kur gazetarët janë viktima të veprave penale. Këto të dhëna nuk ndahen apo gjenerohen në bazë të fazës së procedurës penale në rastet kur gazetarët janë viktima të krimit, as në aspektin gjinor, etnik apo kritere të tjera socio-demografike.

Edhe pse sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial janë në proces të funksionalizimit të sistemit informativ të menaxhimit të lëndëve, ky sistem nuk do të konsolidojë të dhëna dhe statistika në lidhje me profesionin e gazetarit.

# IV

## Siguria fizike

2,66



1.00  
2.00  
3.00  
4.00  
5.00  
6.00  
7.00



Ka raste të rënda të kërcënimeve dhe sulmeve aktuale kundër gazetarëve dhe organizatave të medias, përfshirë vrasjet.

Nuk ka pasur raste të sulmeve aktuale, asnjë kërcënim kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve, as nuk ka pasur kërcënime dhe ngacmime jo fizike kundër gazetarëve dhe mediave.

# Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk lidhen me sigurinë fizike

**Rezultati për vitin 2021: 2,64 / Rezultati për vitin 2022: 2,17**

**Krahasuar me vitin 2021 kur kanë ndodhur 13 raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike, gjatë vitit 2022 ky numër është rritur në 19. Situata është përkeqësuar sidomos për shkak se shumica e këtyre kërcënimeve ndaj gazetarëve vijnë nga njerëz me ndikim, si Zotëria e Parë, Ministri i Punëve të Brendshme, Shefi i Kabinetit të Kryeministrit dhe zyrtarë të tjerë të lartë në Kosovë.**

Gjatë vitit 2022, numri i kërcënimeve dhe ngacmimeve jo-fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave është rritur në krahasim me vitin 2021. Dy raste nga 19 kërcënime jofizike, ku përfshihen deklarata agresive, fyerje, kërcënime verbale dhe gjuhë denigruese, përfshijnë zyrtarë publikë, zyrtarë të lartë dhe njerëz me ndikim në Kosovë. Në prill të vitit 2022, ministri i punëve të brendshme, Xhelal Sveçla, pasi u pyet për punësimin e motrës së tij nga Ministria e Bujqësisë, e cilësoi pyetjen e Besarta Hotit si "budallallëk". Shefi i Kabinetit të Kryeministrit Kurti, Luan Dalipi përmes një postimi në Facebook më 3 mars 2022 sulmoi në mënyrë të paprecedentë mediat e Kosovës duke i lidhur me "bizneset kriminale", dhe duke u bërë thirrje atyre që i dallon si "qytetarë dinjitoz" që t'i bojkotojnë ato. Prindon Sadriu i cilësoi gazetarët si "ndërmarrje të përbashkët kriminale". Bashkëshorti i Presidentes është gjithashtu diplomat i rangut të lartë në Ministrinë e Jashtme. Si dhe rasti i gazetarit Bojan Tomic të RTK2, ndaj të cilit kryetari i Komunës së Shtërpçës, Dalibor Jevtiq, ka përdorur gjuhë denigruese. Atij nuk iu dha përgjigje dhe u ofendua para gazetarëve të tjerë. Pjesa tjetër e rasteve përbëhet kryesisht nga sulme verbale, kërcënime verbale dhe online, siç është rasti i gazetarit Diamant Bajra të Gazetës Blic, i cili ka marrë mesazhe kërcënuese në llogarinë e tij në TikTok. Në anën tjetër, gazetarja e Kallxo.com, Arjana Berisha, është kërcënuar përmes telefonit nga një shofer autobusi pasi ka raportuar për vozitjen e tij. Gazetarja Berisha ka pranuar një video nga pasagjerët e kësaj linje dhe sapo e ka publikuar ka marrë një telefonatë kërcënuese, me sharje dhe ofendime – e cila është incizuar. Rasti i fundit i gjuhës denigruese nga personazhet publike që ka ndodhur gjatë vitit 2022 është ndaj Arsim Lanit të T7 dhe Leonard Kërqukit të T7 dhe Gazetës Express. Salih Zyba, deputet i partisë në pushtet, përmes një postimi në Facebook në profilin e tij personal, ka edituar një video duke krahasuar dhe përpiluar dy video – njëra e vitit 2016 dhe tjetra e vitit 2022, të cilat i ka publikuar për të denigruar gazetarët e lartpërmendur. Rasti i fundit i ndodhur

— TREGUESI 4.1

gjatë vitit 2022 ishte ai i Saranda Ramaj, gazetares së Koha Group, e cila u kërcënua nga Kimete Gashi, anëtare e prokurimit në Komisionin për Buxhet dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës për shkak të raportimit të saj për parregullsi në kontraktimin e barnave mjekësore. Për më tepër ajo e quajti Ramajn "një gazetares të zhurmshme dhe jashtëzakonisht keqinformuese.

# Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

**Rezultati për vitin 2021: 2,54 / Rezultati për vitin 2022: 2,54**

**Në krahasim me vitin 2020 dhe 2021, gjatë vitit 2022 nuk ka pasur raste të kërcënimeve ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve.**

Gjatë vitit 2022 në Kosovë nuk ka ndodhur asnjë vrasje e gazetarëve.

# Sulmet fizike

**Rezultati për vitin 2021: 3,40 /  
Rezultati për vitin 2022: 2,98**

**Numri i rasteve të sulmeve fizike ndaj gazetarëve është rritur në katër krahasuar me vitin e kaluar. Për më tepër, siguria e gazetarëve u rrezikua edhe me shumë se më parë, sepse këto raste ishin intensifikuar dhe shumica e rasteve ndodhën në pjesën veriore të Kosovës, ku Policia e Kosovës, KFOR-i dhe policia e EULEX-it kishin qasje të kufizuar.**

Gjatë vitit 2022 në Kosovë janë shënuar 8 raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve, pesë prej të cilave kanë ndodhur brenda katër javësh në pjesën veriore të Kosovës. Më 17 nëntor, kameramani i portalit Insajderi, Jetmir Muji është sulmuar fizikisht nga një grup vendasish, të cilët ende nuk janë identifikuar. Më pas më 9 dhe 10 dhjetor janë sulmuar ekipi i Kallxo.com dhe ekipi i RTV Dukagjinit. Ekipit të Kallxo.com i janë afruar një grup personash të maskuar derisa ishin duke vozitur, ndërsa ekipi i RTV Dukagjinit është gjuajtur me eksploziv gjatë raportimit live – eksplozivi ka shpërthyer disa metra larg ekipit. Ekipi i Klan Kosovës i përbërë nga gazetari Haris Ademi dhe kameramani Elsad Sinani gjatë raportimit në afërsi të fshatit Çabër të komunës së Zubin Potokut janë gjuajtur me gurë, si dhe janë ofenduar nga një grup banorësh.

Një ekip tjetër i RTV Dukagjinit është sulmuar në fillim të vitit teksa raportonte në Prishtinë për deklarin e të hyrave në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa gazetarja e PSB-së Qëndresa Duraku dhe kameramani Besnik Latifi, i cili njëkohësisht është edhe anëtar i bordit të AGK-së, janë sulmuar nga njëri prej tregtarëve teksa po raportnin live në tregun e gjelbër.

# Kërcënimet dhe sulmet ndaj organizatave mediale dhe asociacioneve të gazetarëve

**Rezultati për vitin 2021: 3,46 / Rezultati për vitin 2022: 2,97**

**Në krahasim me një vit më parë, këtë vit numri i sulmeve ndaj institucioneve mediatike, organizatave, mediave dhe asociacioneve të gazetarëve është dyfishuar. Në vitin 2021 ishin 3 raste, ndërsa gjatë vitit 2022 ishin 6 raste.**

Dy nga këto raste ishin sulme kibernetike ndaj mediave online; i pari drejt "Buletini Ekonomik" dhe i dyti drejt NACIONALE-s. Pjesa tjetër e rasteve kanë të bëjnë kryesisht me politikanë që nuk përmbahen nga deklaratat kundër mediave, siç është rasti i ish-kryeministrit, Ramush Haradinaj, deputet i Kuvendit të Kosovës aktualisht, i cili i referohet mediave në Kosovë dhe Shqipëri si "mercenarët" dhe "të shiturit". Poashtu edhe rasti i ish-këshilltarit politik të kryeministrit Kurti, Hysamedin Ferraj dhe ish-deputetit të VV-së, Sadri Ramabaja, të cilët përdorën gjuhë denigruese ndaj NACIONALE-s për raportimin e kësaj të fundit për grevën e mësimdhënësve; si dhe rasti i fundit në fund të dhjetorit ku televizioni Klan Kosova u kërcënua nga Drejtori i Financave të Post-Telekomunikacionit (ndërmarrje publike). Një nga rastet më të rënda ishte ndaj të gjitha mediave online, pasi deputetja e partisë në pushtet, Fitore Pacolli bëri thirrje për një rregullim qeveritar të mediave, veçanërisht të portaleve online, ndaj të cilit reagoi AGK dhe theksoi faktin se në Kosovë shumica e mediave janë të regjistruara si biznese në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës - ARBK, ndërsa pjesa tjetër e mediave janë të regjistruara si OJQ. Mediat në Kosovë e rregullojnë veprimtarinë e tyre përmes ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, si dhe Kodit të Sjelljes së Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.



**Titulli**  
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor  
Raport Narrativ 2022 - Kosovë

**Botues**  
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



**Autore**  
Getoarbë Mulliqi Bojaj

**Ekspert ligjor**  
Yll Zekaj

**Ekspert i mediave**  
Abit Hoxha

**Dizajni**  
comma.rs

Ky botim është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe organizatës Civil Rights Defenders. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian dhe organizatës Civil Rights Defenders

